



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.1356/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Halide Reka, kryetare e kolegjit, Gëzim Llulluni dhe Nora Bllaca Dula, anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.L nga Podujeva, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson H.P., avokat nga Podujeva, kundër të paditurës Komuna e Podujevës-Drejtoria e Arsimit në Podujevë, me objekt kontesti kompensimin e pagave jubilarë dhe pagave përcjellëse për në pension, duke vendosur sipas ankesës së të autorizuarit të paditësit, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.15/20, të dt.27.01.2021, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 17.03.2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e të autorizuarit të paditësit B.L nga Podujeva, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.15/20, të dt.27.01.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar, C.nr.15/20, të dt. 27.01.2021, ka vendosur:

I.**REFUZOHET** në tërësi kërkesëpadia e paditësit B.L nga Podujeva, me të cilën ka kërkuar që të: **APROVOHET** kërkesëpadia e paditësit për kompensimin e shpërblimit jubilar dhe për përcjelljen në pension të punëtorit dhe të **DETYROHET** e paditura Komuna e Podujevës, Drejtoria Komunale e Arsimit që të paguaj shumën e përgjithshme prej 1,547.28 euro dhe kjo në lartësinë e 6 pagave bazë e që janë: (3 x 262.38=787.14), për shpërblim jubilar dhe (3 x 262.38=787.14), për përcjellje të punëtorit në pension, të gjitha këto me kamatë ligjore nga dita e ushtrimit të padisë si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi që do të shkaktohen këtu në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë

II. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit të paraparë ligjor ankesë ka paraqitur i autorizuari i paditësit duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim për Gjykatën e Apelit që ankesa të aprovohet si e bazuar, aktgjykimi i ankimuar të priset në tërësi dhe lënda të kthehet në rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë apo vet Gjykata e Apelit të aprovoj kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar.

Përgjigje në ankesë është paraqitur nga e paditura, me propozim që ankesa të refuzohet si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të autorizuarit të paditësit është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi B.L nga Podujeva, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me dt. 09.01.2020 ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Podujevës-Drejtoria e Arsimit Podujevë, me anë të së cilës ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit në emër të tre pagave përcjellëse për pension si dhe tre pagave për shpërblim jubilar, t'ia paguaj shumën në lartësi prej 1,547.28 €uro, me kamatë ligjore nga dita e ushtrimit të padisë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimin nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.15/20, të datës 27.01.2021, me të cilin e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimin të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se nga provat e administruara gjykata gjeti se nuk është kontestuese se paditësi ka qenë punëtor në Shkollën "Shefki Latifi" në fshatin Pollatë, Komuna e Podujevës, nga viti 1970 e deri 25.02.2015 kur paditësi është pensionuar. Nga pretendimet e palëve ndërgjyqëse dhe bazuar në provat e administruara, gjykata e shkallës së parë gjeti se kërkesa për kompensim në emër të shpërblimit jubilar dhe 3 pagave përcjellëse në pension është parashkruar. Gjykata erdhi në këtë përfundim duke u bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës nr.03/L-212 ku është paraparë se : *"Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës"*, ndërsa në nenin 341 par 2. Të LMD-së nr.04/L-007 për kërkesat e tilla është paraparë afati i parashkrimit ashtu që: *"Parashkrimi krijohet kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj, brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit"*, e po ashtu në nenin 357 par. 1 të LMD-së parashihet: *"Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dëmin"*, i cili afat në rastin konkret ka kaluar para se të jetë ngritur padia pasi që nga ata e arritjes së pensionimit të paditësit me 25.02.2015, e deri te ngritja e padisë me 09.01.2020 kanë kaluar mbi 4 vite, me çka është parashkruar kërkesa për realizimin e kompensimit të pagave përcjellëse në pension dhe shpërblimit jubilar. Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur konform dispozitës së nenit 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit

194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat janë pretenduar nga pala ankuese.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të autorizuarit të paditësit se aktgjykimi është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike në këtë çështje juridike kontestimore. Edhe përkundër faktit se gjykata e shkallës së parë nuk ka caktuar shqyrtim kryesor gjyqësor, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, vendimi është marrë në mënyrë të ligjshme duke u bazuar në shkresat e lëndës dhe provat e ofruara nga palët ndërgjyqëse, kjo bazuar në nenin 399 të LPK-së ku përcaktohet se: *“399.1 Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija. 399.2 Kërkesëpadija është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadija qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”*. Paditësi me provat e ofruara në gjykatë ka vërtetuar faktin se i njëjti ka ushtruar padinë e parë për kompensimin e pagave jubilarë dhe pagave përcjellëse në pension me dt.18.02.2019, me numër C.nr.77/20 por e njëjta është konsideruar e tërhequr me aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë C.nr.77/2019 të dt. 08.04.2019.

Në këtë kuptim, bazuar në faktin e pakontestueshëm se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura nga dt.01.09.1970 deri me dt. 05. 02.2015, rrjedh se i njëjti është pensionuar dhe ka mbushur 45 vite të përvojës së punës së pandërprerë para hyrjes në fuqi të kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar të dt. 11.04.2014, ndërsa e drejta për të kërkuar kompensimin në emër të pagave jubilarë dhe pagave përcjellëse për në pension i ka lindur me hyrjen në fuqi të kësaj kontrate, pra nga data 01.01.2015. Në këtë kuptim, meqë paditësi padinë për kompensimin e shpërblimit dhe pagave përcjellëse për në pension e ka paraqitur me dt.09.01.2020, rrjedh se kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës, në kuptim të dispozitës nga neni 87 e Ligjit të Punës, Nr.03/L-212, ku parashihet që *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Referuar kësaj dispozite, rrjedh se paditësi e ka lëshuar afatin pre 3 vitesh për të kërkuar realizimin e një të drejte nga marrëdhënia e punës - në rastin konkret kompensimin e shpërblimit jubilar dhe 3 pagat përcjellëse në pension. Mbi këtë bazë, kërkesëpadija duhet të refuzohet si e pa bazuar, nga çka rrjedh se aktgjykimi i atakuar është i drejtë dhe është marrë në përputhje me dispozitat e lartë cekura.

Edhe në rast se merret i mirëqenë pretendimi i paditësit lidhur me faktin se i njëjti ka ushtruar padi lidhur me kompensimin e pagave jubilarë dhe pagave përcjellëse në pension me dt.18.02.2019, edhe përkundër faktit se e njëjta konsiderohet e tërhequr me aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë, në rastin konkret përsëri kemi të bëjmë me parashkrim, duke ju referuar dispozitës së sipërcituar.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lart cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragrafi 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-PRISHTINË

Ac.nr.1356/2021, dt.17.03.2022.

**Kryetarja e kolegjit,
Halide Reka d.v.**